



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

PËR KONSULTIM PUBLIK

Projekt

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR
CAKTIMIN E SHPENZIMEVE PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE PRANË
AUTORITETIT TË KONKURENCËS”**

Në mbështetje të neneve 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja b) të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

Komisioni i Konkurrencës

Vendosi:

Në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me vendimin nr 10, datë 29.06.2004 të Komisionit të Konkurrencës, ndryshuar me Vendimin nr.167, datë 21.12.2010 të Komisionit të Konkurrencës; ndryshuar me Vendimin nr.242, datë 03.09.2012 të Komisionit të Konkurrencës, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 1 i Rregullores ndryshohet si më poshtë:

1. Tërheqja e “Formularit të njoftimit të përqendrimit” nga ndërmarrjet pjesëmarrëse të përcaktuara në nenin 12, të Ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, (të cilat bashkohen, përftojnë kontrollin, si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes preket nga transaksioni i kryer) bëhet kundrejt pagesës me vlerë 25.000 lekë.
2. Autorizimi “Për realizimin e përkohshëm të përqendrimit” që jepet nga Komisioni i Konkurrencës në bazë të kërkesës së ndërmarrjeve pjesëmarrëse, në përputhje me nenin 60, pika 1, të Ligjit Nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, do të jepen kundrejt pagesës me vlerë 500.000 lekë.
3. Autorizimi “Për realizimin e përqendrimit” që jepet nga Komisioni, në përputhje me nenin 56 të Ligjit nr 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, merret kundrejt pagesës me vlerë 2 000 000 lekë.

Pas pikës 3 të nenit 1 shtohet pika 4:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

4. Autorizimi “Për realizimin e përqendrimit” që jepet nga Komisioni, në përputhje me nenin 57 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, merret kundrejt pagesës me vlerë 3 000 000 lekë.

Neni 2

Neni 4 i rregullores ndryshohet si më poshtë:

Pagesat e parashikuara në këtë rregullore, do të bëhen në llogarinë bankare të Autoritetit, kundrejt mandat arkëtimit.

Neni 3

Këto ndryshime hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit nga Komisioni i Konkurrencës.

Miratuar me Vendimin nr.____, datë ____ .12.2018 të Komisionit të Konkurrencës.

Për çdo koment, sugjerim, vërejtje kontaktoni në Autoritetin e Konkurrencës në adresën: Rruga "Sami Frashëri" nr.4, kati 4, Tel 04 22 34 504, Fax. 04 22 34 497 ose në adresën elektronike competition@caa.gov.al deri në datë 30/11/2018.